

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## “FLUTURO ME SHQIPEN” NGA DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE !

Projekti “Fluturo me Shqipen” ka si qëllim kryesor evidentimin e rëndësisë së produkteve “Made in Albania” dhe promovimin e tyre, si dhe mbështetjen për krijimin e një zinxhiri nga prodhimi deri në penetrimin drejt tregjeve rajonale dhe drejt konsumatorit shqiptar në Diasporë. Sipërmarrja e Diasporës zotëron kapacitetin e duhur për të ardhur në ndihmë të fuqizimit të produkteve lokale nëpërmjet forcimit të Brandit Shqiptar. Përveç të tjerash, kjo iniciativë do të ndikojë pozitivisht në sektorin e punësimit dhe rritjen e të ardhurave dhe rrjedhimisht një ekonomi të qëndrueshme. Kjo do të jetë një shoqëri që synon jo më pak se 200 aksionerë. Synohet që aksionerët të jenë biznese të Diasporës, dhe/ose individë në moshë deri në 40 vjeç, me qëllim promovimin e inovacionit.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## PANDEMIA, BB: REMITANCAT NË SHQIPËRI NË 2020 ARRITËN 1.5 MLD DOLLARË

Industria e dërgesave të parave ka qenë pjesë e përsheptimit të dixhitalizimit, që është e vëzhguar në shumë dimensione të jetës gjatë krizës COVID 19. Duke filluar nga qershori 2020, flukset e remitancave përmes kanaleve dixhitale janë rritur, sipas një raporti të ri të Bankës Botërore, veçanërisht për emigrantët me qasje në llogaritë bankare dhe kartat e kreditit. Raporti tregon se Shqipëria renditet në dhjetëshen e përfituesve më të mëdhenj të remitancave në Europë dhe Azinë Qendrore, ndonëse në shifra më të ulëta se sa rajoni. Sipas këtij raporti, përfituesi kryesor në Europë i remitancave ka qenë Ukraina, ndjekur nga Rusia dhe Uzbekistani. Shqipëria, e fundit me 1.5 miliardë dollarë në 2020, ndërsa në raport me PBB, 9.7%.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## UDHËTIMI DREJT ITALISË, I DETYRUESHËM FORMULARI EUROPIAN DPLF

Formulari i lokalizimit Digjital të Pasagjerëve përdoret nga autoritetet e shëndetit publik për të lehtësuar gjurmimin e kontaktit në rast se udhëtarët janë të ekspozuar ndaj një sëmundje infektive gjatë udhëtimit të tyre me aeroplan, anije, hekurudhë, autobus ose automjet. Informacioni që udhëtarët japin në DPLF mund të përdoret nga autoritetet e shëndetit publik në vendet e destinacionit për të kontaktuar me shpejtësi udhëtarët, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të udhëtarëve dhe kontakteve të tyre, si dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të sëmundjes. Aktualisht forma digjitale është duke u përdorur vetëm nga Italia ndërsa shtetet e tjera janë ende në aplikimin në formë të shkruar në letër.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

SHIFRAT/ EMIGRACIONI NETO, SA KANË IKUR NGA SHQIPËRIA DHE SA JANË KTHYER



TURQI/ LINDA KALEMI: DIASPORA DUHET TË ORGANIZOHET PËR TË SIGURUAR VOTËN



KOSOVË-SHQIPËRI, PAJTIM I INSTITUCIONEVE PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 <sup>.22</sup>	16.62